



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.101/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në vend publik, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 700.00 (shtatqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.09.2017, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se aktivistët e LVV, kanë vërejtur se në lagjen Ulpiana mbrapa lokaleve të “Lesnës” në Prishtinë, në trafostacionin elektrik është vendosur poster i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik AAK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2017, subjekti politik AAK, thekson se vendosja e posterit nuk është bërë nga ana e AAK-së, por mund të jetë bërë nga qytetar apo individ të pa identifikuar, më tej në përgjigje kanë shtuar se kanë ndërmarr masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre lidhur me evitimin e shkeljes i kanë bashkëngjitur fotografi nga vendi ku është larguar posterit.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterit i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, është vendosur në trafostacion elektrik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterit i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, nga radhët e subjektit politik AAK është vendosur në trafostacion elektrik. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik, në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjobë paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 101/2017 më datën 03.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.